



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
GRUPI I PUNËS AD-HOC



**REKOMANDIME MBI RAPORTIN E
ANALIZËS SË REZULTATEVE TË
PYETËSORIT TË VLERËSIMIT TË
CILËSISË SË PROGRAMEVE TË
STUDIMIT NËPËRMJET ALUMNI-T
UNIVLORA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
GRUPI I PUNËS AD-HOC

Nr.	Problematikat e indentifikuara	Rekomandimet/Plani i masave	Njësitë përgjegjëse
1.	Përfshirja dhe angazhimi i shumë i ulët i Alumni-t në sondazh	- Hartimi i një strategjie të qartë institucionale, e cila duhet të vihet në zbatim që përpara se studentët të diplomohen. Kjo strategji duhet të përcaktojë mënyrat e përfshirjes së vazhdueshme të Alumni në jetën akademike dhe institucionale të universitetit. - Nxitja e studentëve që gjatë kohës që janë ende në UV të krijojnë rrjetin e Alumni-t, të organizuar sipas fakulteteve, me qëllim ndërtimin e një baze të qëndrueshme komunitare që ruhet pas diplomimit. - Përgatitja dhe plotësimi i një pyetësoi në momentin e diplomimit, i cili do të shërbejë për mbledhjen e të dhënave në lidhje me gjurmimin e të diplomuarve, planet e tyre për karrierë dhe kontaktet e tyre të përditësuara. - Organizimi i “Javës së Alumni-t” dhe krijimi i një rrjeti me emrin “UNIVLORA Alumni Ambassadors”, me qëllim rritjen e ndërveprimit ndërmjet Alumni dhe institucionit, si dhe përfaqësimin e UV në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.	- Zyrat përkatëse në Rektorat - Ngritja e komisioneve ad-hoc për këtë qëllim - Njësitë Kryesore - Njësitë Bazë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
GRUPI I PUNËS AD-HOC

		✚ Përfshirja e një seksioni të dedikuar për Alumni-n në të gjitha konferencat shkencore që organizohen nga UV, përfshirë edhe ato me pjesëmarrje studentore, me qëllim krijimin e hapësirave për bashkëpunim dhe rrjetëzim profesional. ✚ Krijimi i një platforme digjitale të dedikuar për Alumni-n, si një ndërfaqe brenda faqes zyrtare të universitetit (univlora.edu.al), e cila të mundësojë gjithashtu lidhjen me rrjetet sociale dhe ndjekjen e aktiviteteve të Alumni-t në kohë reale. ✚ Angazhimi i vazhdueshëm i Alumni-t në jetën e universitetit – Alumni-t duhet të jenë të ftuar rregullisht në aktivitete akademike dhe sociale të UV, të vlerësohen për kontributet e tyre dhe të ndihen pjesë e pandarë e komunitetit universitar. ✚ Ndërtimi i bashkëpunimeve të qëndrueshme me biznese për praktika dhe rekrutime të drejtpërdrejta.	
2.	Kufizime dhe mangësi në përmbajtjen e pyetësorit dhe mënyrën e administrimit të pyetësorit të Alumni-t, me qëllim sigurimin e të dhënave të besueshme dhe të përgjithësueshme	✚ Pyetësori i Alumni-t i administruar nuk përmban pyetje që lidhen me mënyrën se si UV i përfshin Alumni-t në zhvillimin e vet akademik, shkencor dhe institucional.	▪ SSBCA ▪ Ngritja e komisioneve ad-hoc për këtë qëllim ▪ Njësitë Kryesore ▪ Njësitë Bazë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
GRUPI I PUNËS AD-HOC

		✚ Zgjerimi i përmbajtjes së pyetësorit – Aktualisht nuk përfshihen pyetje që lidhen me përfshirjen e Alumni-t në aktivitete të ndryshme të organizuara nga UV si: konferenca shkencore, tryeza të rrumbullakëta, panele diskutimi, aktivitete sociale, etj. Këto janë të rëndësishme për të kuptuar nivelin e angazhimit të tyre real. ✚ Pyetjet e seksionit të tretë mund të shtoheshin për të plotësuar kuadrin e pyetjeve mbi programet. P.sh., pyetja 19 mund të plotësohej me një pyetje shtesë, për aspektet e programeve që i kanë ndihmuar ose jo (marrë në konsideratë që 46.7% e pjesëmarrësve kanë qenë neutralë ose nuk kanë qenë dakord që programet të kenë qenë shumë të vlefshme për ta) ✚ Pyetjet e hapura të pyetësorit të Alumni-t kur krahasohen me pyetjet e hapura të sondazheve që bëhen me studentët aktualë, nuk evidentojnë ndryshime në kërkesa apo sugjerime ndërmjet kërkesave të studentëve që ndjekin aktualisht studimet në UV dhe atyre që janë diplomuar. Kjo sjell nevojën për rishikim të tyre në pyetësor.	
--	--	---	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
GRUPI I PUNËS AD-HOC

		✚ Sondazhi duhet të kryhet çdo vit dhe jo një herë në tre vjet. Kjo gjë sjell humbjen e pjesëmarrësve në sondazh, pasi gjurmimi dhe ndjekja e tyre bëhet më e vështirë. ✚ Zgjerimi i formateve të grumbullimit të të dhënave – Pyetësi duhet të kombinojë pyetje të mbyllura dhe të hapura, si dhe të plotësohet me fokus-grupe për të mbledhur të dhëna cilësore dhe tematike mbi përvojat e Alumni-t dhe sugjerimet e tyre. Këto fokus grupe mund të realizohen edhe online. ✚ Përfshirja e analizave përtej sondazhit në raportet institucionale – Zyrtarë përkatës në analizën vjetore të punës duhet të përfshijnë edhe raportime mbi përfshirjen e Alumni-t në aktivitetet e UV, impaktin e tyre në këto takime, përfitimet e ndërsjella dhe jo vetëm rezultatet e pyetësorit. ✚ Qartësimi i ndikimit të sondazhit në përmirësimin e cilësisë – Aktualisht nuk është i qartë ndikimi i këtij sondazhi në përmirësimin e mësimdhënies dhe rishikimin e programeve të	
--	--	---	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
GRUPI I PUNËS AD-HOC

		studimit. Rezultatet duhet të përdoren konkretisht për zhvillimin e mëtejshëm akademik të UV. ✚ Krijimi i “Këndit të Alumni-t” në çdo fakultet – Ky kënd do të përfshijë Alumni-n me arritje të spikatura sipas fushave të studimit, duke shërbyer si model frymëzues për studentët aktualë dhe si urë lidhëse me tregun e punës. ✚ Hartëzimi i “stakeholders”-ave potencialë për punësimin e studentëve – Duhet të krijohet një databazë që lidh programet e studimit me aktorët e tregut të punës. Kjo do të ndihmojë në ndjekjen dhe vlerësimin më të mirë të karrierës së të diplomuarve dhe në krijimin e lidhjeve të dobishme për UV.	
3.	Problematika në lidhje me cilësinë e programeve të studimit që UV ofron	✚ Rritja e komponentit praktik në programet e studimit”: • Rishikimi i strukturës së lëndëve për të përfshirë më shumë përmbajtje praktike dhe zbatim të njohurive teorike. • Futja e projekteve praktike në bashkëpunim me biznese, institucione dhe organizata. • Zhvillimi i praktikave profesionale të mbikëqyrura dhe të detyrueshme për studentët.	▪ SSBCA ▪ Zv. Rektori Akademik ▪ Njësitë Kryesore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
GRUPI I PUNËS AD-HOC

	• Të përmirësohet strategjia për kryerjen e praktikave, të cilat duhet të jenë të vazhdueshme, çdo vit dhe shkallë-shkallë drejt përgatitjes profesionale (p.sh., zhvillimi i seminareve të praktikumit krahas praktikës në terren). ✚ Përmirësimi i infrastrukturës laboratorike dhe teknike: • Investimi në laboratorë bashkëkohorë dhe pajisje që përputhen me kërkesat e tregut të punës. • Përfshirja e softuerëve profesionalë në mësimdhënie (p.sh. Excel i avancuar, SPSS, AutoCAD, programe kontabiliteti, etj.). • Punësimi i stafit teknik ndihmës për mirëmbajtjen dhe asistencën në laboratorë. ✚ Zhvillimi i moduleve të dedikuara për tregun e punës: • Krijimi i lëndëve ose trajnimeve për orientim në karrierë, teknika aplikimi për punë, intervista pune dhe ndërtim CV-je. • Informim i studentëve për kërkesat reale të tregut në sektorë të ndryshëm. • Të sigurohet njohuri bazë për profesionet e lidhura me drejtimin e studimit. ✚ Mbështetja e iniciativës sipërmarrëse dhe aftësive për të marrë risk:	▪ Njësitë Bazë ▪ Grupet kërkimore dhe mësimore të njësive bazë
--	---	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
GRUPI I PUNËS AD-HOC

	• Futja e moduleve ose kurseve për sipërmarrje, menaxhim biznesi dhe planifikim financiar. • Organizimi i konkurseve për ide biznesi dhe mentorim nga profesionistë të fushës. • Nxitja e mendësisë së pavarur dhe të gatshme për të ndërmarrë iniciativa në treg. ✚ Ruajtja dhe forcimi i cilësisë së stafit akademik: • Vlerësohet niveli i mirë i pedagogëve dhe marrëdhënia e tyre me studentët — ky potencial duhet të përdoret për të përmirësuar mënyrën e mësimdhënies me qasje më moderne, interaktive dhe praktike. • Të inkurajohet zhvillimi i vazhdueshëm profesional i stafit për të qëndruar në hap me zhvillimet e fushës. ✚ Angazhim dhe pjesëmarrje aktive e stafit akademik dhe ndihmësakademik, duke përdorur qasjen e bashkëkrijimit, me qëllim përmirësimin e programeve: • Rritje e përgjegjësisë dhe angazhimit institucional nëpërmjet shpërndarjes së rezultateve të pyetësorit të Alumni-t tek departamentet që ofrojnë programe studimi, jo vetëm në formë shkresore, por edhe përmes organizimit të workshop-eve apo seminareve informuese nga SSBCA.	
--	--	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË GRUPI I PUNËS AD-HOC

GRUPI I PUNËS:

Prof. Asoc. Majlinda ZAHAJ, Zv. Rektor Akademik – **Kryetar**

Dr. Amali ÇIPI, Zv. Dekan Akademik FE - Anëtar

Dr. Eljona PROKO, Zv. Dekan Akademik FSHTN – Anëtar

Dr. Entela AVDULAJ, Zv. Dekan Akademik FSHH – Anëtar

Prof. Asoc. Fatjona KAMBERI, Drejtues i QKSH në FSH – Anëtar